

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 20.09.2023 (dymijë e njëzet e tre), , u paraqitën Shitësi dhe Blerësi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit-Blerje Kuotash, me termat si më poshtë vijon:

Z.Andri Nasufi shtetas shqiptar, i biri Rezeart, lindur ne Tirane , i datelindjes 10.07.2002, me banim ne , Tirane, i identifikuar me kartë identiteti me nr.033859120 dhe nr.personal K20710051L, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e ortakut të shoqërisë **“O&A” shpk**, shoqëri e themeluar më 15.10.2021 dhe e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 18.10.2021 me NIPT M212218017P këtej e tutje quajtur "Shitesi";

DHE

Z.Tufik Kurti shtetase shqiptar, i biri e Perparim lindur në Shupenze më datë 04.12.1972 dhe banues ne Tirane, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr.036831716 dhe nr.personal H21204005I, këtej e tutje quajtur **“Bleresi”**

DUKE PATUR PARASYSH SE :

- i. Blerësi është në procesin e blerjes së kuotës së shoqërisë me emërtim tregtar **““O&A” shpk**, një Shoqëri e organizuar rregullisht dhe themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë më datë 18.10.2021 me Numër identifikimi të personit të tatueshëm (NIPT) M12218017P, me seli ne Tirane **TIRANE Rruga "Pandi Dardha, Pall.56, Shk.1, Ap. 3, Njesia Administrative Nr 11 Tirane** këtej e tutje quajtur **“Shoqëria”**.
- ii. Shitësi është zotëruar dhe posedues te padiskutueshëm të 100% kapitalit të shoqërisë (këtëj e tutje e quajtur kuota).
- iii. Shoqëria ka një kapital prej njëqind (100000) Lekë, të ndarë në një kuotë të regjistruara dhe me vlerë nominale të kuotës prej 1 (një) Lekë, e cila është nënshkruar dhe derdhur rregullisht dhe në mënyrë të vlefshme.

Me vendimin Nr. 1 e datës 20/09/2023 të Ortakëve të shoqërisë është vendosur shitja e kuotave në masën 100% të tyre nga ana e Ortakut të Shoqërisë **Z.Andri Nasufi** , në masën 100% dhe blerja e tyre nga **Z. Tufik Kurti** në masën 100%.

Shitja në masën prej 100% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë **“O&A shpk**. sjell humbjen e të drejtës së pronësisë mbi kuotat e kapitalit themeltar të ortakut të shoqërisë **Z.Andri Nasufi**, në masën 100%, si rrjedhojë e këtij transaksioni shitje kuotash, të shprehur në vendimin e Ortakut, datë 20/09/2023.

Shitësi **Z.Andri Nasufi** është plotësisht dakord të shesi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë përkatësisht në masën prej 100% të kuotave që ai zotëron në shoqërinë **“O&A”shpk**. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit **Z. Tufik Kurti** ne masën 100 %.

Blerësi **Z. Tufik Kurti** është plotësisht dakord që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 100% të kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare **““O&A shpk**



MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, ortaku **Z.Andri Nasufi** humbet pronësinë në masën 100%, të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë “**O&A**”shpk, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e shitura të shoqërisë, ndërsa blerësi, bëhet pronar në masën **Z. Tufik Kurti** në masën 100% të kuotave të shitura.

Shoqëria Tregtare“**O&A**” shpk pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si Ortak te saj me pjesëmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

- **Z. Tufik Kurti** zotëron 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë “**O&A**”shpk.. të barabartë me 1 (një) kuotë.

Shoqëria do të ketë administrator **Z. Tufik Kurti**

Adresa e shoqërisë do të jete ne Rruga Maliq Muco Nr. 2 Tirane

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë “**O&A shpk** do të jetë shuma prej 100.000 (njëqind mije) Lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të kuotave sipas Statutit të Shoqërisë. E gjitha shuma, për të cilën palët bien dakort të jetë e drejtë, i paguhet Shitësave nga Blerësi pa praninë e noterit.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë dhe një kopje e mban Noteri. Termat e kësaj kontrate, pasi u redaktuan prej meje noterit, ju lexuan palëve kontraktuese, të cilët u shprehën se e kanë kuptuar dhe pranuar atë dhe të cilët e nënshkruajnë atë pa vërejtje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë .

PALËT

SHITESI
Z.Andri Nasufi

Andri Nasufi


BLERESI
Z. Tufik Kurti

Tufik Kurti
